



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

V E N D I M

Nr. 34, Datë 26/05/2017

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën nr. 69, datë 14.07.2016 e z. I.S., ku pretendohet diskriminim nga ana IEVP¹ Zahari, Krujë për shkak të gjendjes shëndetësore².

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O N:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues

Pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, është paraqitur ankesa nr. 69, datë 14.07.2016 e ankuesit I.S., ku pretendohet diskriminim nga ana IEVP Zahari, Krujë për shkak të gjendjes shëndetësore.

Ankuesi, i lindur në Kënetë, Durrës, më 20.08.1955, vuan dënimin pranë IEVP Zahari, Krujë³. Sipas shpjegimeve të dhëna, ai sqaron se është Invalid i Grupit II, por Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë nuk i ka njohur gjendjen shëndetësore, ndërsa nga ana e IEVP, ku vuan

¹ Instituti i Ekzekutimit të Vendimeve Penale

² Ankuesi vuan dënimin penal pranë kësaj IEVP-je.

³ Referuara Aktit nr. I- 49.3 Prot, datë 01.04.2014 të Ministrisë së Punëve të Brendshme, ankuesi I.S. vuan dënimin për veprën penale “vrasje me dashje” të shtetases B.S., bashkëshortja.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

dënimin, i është hequr mundësia për tu njohur me vendimet e gjykatës, mbi ekspertimet mjekoligjore, lidhur me gjendjen shëndetësore.

Mbështetur në faktin se është Invalid i Grupit II, ai pretendon se i takon të jetojë në një qeli me një shtrat, me banjë e ujë brenda dhe orë më të zgjatura ajrimi. Sipas tij, qelia aktuale ka 5 shtretër; është pa banjë; pa ujë dhe nuk i ofrohen shërbime sanitare.

Përsa më sipër, ankuesi pretendon se gjendja shëndetësore është bërë shkak për diskriminimin e tij, nga ana e IEVP Zahari, Krujë.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri

Gjendja shëndetësore është një nga shkaqet për të cilat Ligji Nr.10 221, datë 4.2.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ofron mbrojtje. Në nenin 1 të tij përcaktohet se: “Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, **gjendjen shëndetësore**, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

1. Për sa më sipër, referuar nenit 33, të ligjit nr. 10 221/2010, përmes shkresës nr. 746 prot, datë 22.07.2016, Komisioneri i është drejtuar ankuesit me kërkesë për plotësim të ankesës me dokumentacionin përkatës që vërteton gjendjen shëndetësore të tij; vizitat shëndetësore dhe rekomandimet e dhëna nga mjekët.

2. Duke mospatur përgjigje zyrtare, përmes shkresës nr. 900 prot, datë 29.09.2016, Komisioneri i është drejtuar ankuesit me një kërkesë të dytë, kujtesë për dërgim informacioni.

- Me shkresë nr. 892, datë 28.09.2016, ankuesi ka vënë në dispozicion të Komisionerit aktet e kërkuara.

3. Me shkresë nr. 746/1 prot, datë 10.11.2016, Komisioneri i është drejtuar për informacion IEVP Zahari, Krujë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, ku i është kërkuar informacion lidhur me pretendimet e ankuesit I.S. Kërkesa konsistonte në informimin e Komisionerit në lidhje me:

- Kushtet e nevojshme infrastrukturore dhe higjeno-sanitare për të dënuarit në tërësi dhe ankuesin në veçanti.
- Kushtet për lëvizjen dhe ajrimin e të dënuarve.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

- Zbatimin e të drejtave të pretenduara nga ankuesi, si person invalid që vuan dënimin në IEVP Zahari, Krujë.
- Përgjigjet që IEVP Zahari, Krujë dhe Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve i kanë drejtuar të dënuarit, pas kërkesave të këtij të fundit për t'u njohur me vendimet e gjykatës dhe për t'iu siguruar kushte me të mira higjeno-sanitare.

4. Përmes aktit nr. 542 prot, datë 11.11.2016, Drejtoria e IEVP, Krujë informon Komisionerin se *“në këtë institucion kemi shërbim mjekësor dhe kujdestar sanitar 24 orësh. Uji, detergjentët dhe përkujdesja e personelit në institucion nuk kanë munguar asnjëherë. Uji është i pandërprerë. Pretendimet që ngre i dënuari I.S. për akomodimin në dhomë me një shtrat, dhe me banjë e ujë brenda në dhomë, si dhe shërbim kujdestar, janë shërbime që i ofrohen të sëmurëve Para dhe Tetraplegjikë, ndërsa Invalidët e Grupit II janë të paaftë për punë, por nevojat e tyre personale i realizojnë vet. Konsulta e fundit është bërë më datë 02.11.2016 tek mjeku endokrinolog i spitalit të Krujës”.*

Përsa i përket pretendimit të ngritur nga ankuesi, se i është hequr mundësia për tu njohur me vendimet e gjykatës, IEVP bën me dije se *“në dosjen e tij nuk rezulton asnjë vendim gjykate që pretendon të mos jetë njohur i dënuari”.*

Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës, bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vlerëson si më poshtë:

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka patur në vëmendje vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr.10 221, datë 04.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”.

Ankuesi I.S., pretendon se për shkak të gjendjes shëndetësore është i diskriminuar nga ana e IEVP Krujë. Ai është Invalid i Grupit II, por Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve Tiranë nuk ia ka njohur gjendjen shëndetësore.

Lidhur me këtë pretendim, bazuar në aktet e administruara, rezulton se:

- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve disponon Kartelën Klinike Nr. 249, Kodi 13039792 të pacientit Isuf Rexhep I.S., e hapur me datën 16.08.2011, ku janë përshkruar gjithë vizitat mjekësore, nga data 04.08.2004⁴, deri në vizitën e fundit, më datë 26.06.2016.
- Më datë 26.05.2015 (akt nr. 799 prot), ankuesi (i dënuari) I.S. i është nënshtruar “Ekspertimit mjeko-ligjor” nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore, që ka bërë

⁴ Kartela reflekton gjendjen shëndetësore të ankuesit që prej vitit 2004, para se ai të ndalohej.

vlerësimin e gjendjes shëndetësore të tij dhe konstatimin e tij si i sëmurë me *Diabet Mellitus, Tipi II*⁵. Në këtë akt ekspertimi theksohet se “në vlerësimin e gjendjes shëndetësore të kryer nga ekspertet mjeko ligjor, Dr. A.S dhe Dr. Z. I, ju bëjmë me dije se duke u bazuar në kriteret mjeko-ligjore, akti mjeko-ligjor paraqitet i rregullt”.

- Më datë 18.02.2016, ankuesi i është nënshtruar “Ekspertimit Mjeko-Ligjor” të radhës nga ana e Institutit të Mjekësisë Ligjore, të cilët pas ekzaminimit të gjendjes shëndetësore të ankuesit, kanë hartuar një Akt Ekspertimi Mjeko-Ligjor ku, sipas konkluzioneve të parashtruara, rezulton se: “Gjendja shëndetësore e shtetasit I.S. është e stabilizuar. Ai (i dënuari) vuan nga Diabeti Mellitus, Tipi II, i ekuilibruar dhe nuk është në kushte të rënda shëndetësore, të cilat kërkojnë kujdes të vazhdueshëm jashtë burgut. Sipas këtij akti, “në gjendjen aktuale që ndodhet i dënuari I.S., sëmundja nga e cila vuan ai, qendrimi në burg nuk përbën rrezik për jetën e tij”.

Për sa më sipër, vërehet se nga ana procedurale Drejtoria e IEVP Krujë ka marrë të gjitha masat që i dënuari, (ankuesi), t’i nënshtrohet kontrollit mjeko-ligjor, por në asnjë prej vlerësimeve të bëra në aktet e ekspertimit, nuk i është konstatuar një fakt i rëndësishëm, sic është Statusi i Invaliditetit të Plotë. Këtë status, ankuesi nuk e gëzon për shkak se vuan nga diabeti, por për shkak të diagnozës “CA e Vezikës Urinare”, ekzaminuar që në vitin 2014 e deri më sot, provuar përmes akteve: Vendim nr. 93, datë 24.01.2014 të KMCA, DRSSH Durrës; Vendim nr. 82, datë 14.01.2015 të KMCA, DRSSH Durrës; Vendim nr. 876, datë 23.03.2016 të KMCA, DRSSH Durrës, ku citohet shprehimisht se: “Z. I.S. plotëson kushtet për të fituar të ardhura për invaliditet të plotë, sepse vuan nga CA e Vezikës Urinare”.

Lidhur me pretendimet e ankuesit, për akomodim në dhomë me një shtrat, me banjë e ujë brenda dhe orë më të zgjatura ajrimi, rezulton se:

- Drejtoria e IEVP, Krujë, përmes Aktit nr. 542 prot, datë 11.11.2016, drejtuar Komisionerit, sqaron se: “... . Pretendimet që ngre i dënuari I.S. për akomodimin në dhomë me një shtrat dhe me banjë e ujë brenda në dhomë, si dhe shërbim kujdestar, janë shërbime që i ofrohen të sëmurëve Para dhe Tetraplegjikë, ndërsa Invalidët e Grupit II janë të paaftë për punë, por nevojat e tyre personale i realizojnë vet. Konsulta e fundit është bërë më datë 02.11.2016 tek mjeku endokrinolog i spitalit të Krujës”.

Përsa më sipër, nga shqyrtimi i akteve të depozituara nga palët rezulton se konstatimi i IEVP Krujë është i pabazuar dhe nuk ka asnjë referencë ligjore dhe/ose nënligjore që të mbështes pretendimin se: “Dhomë me një shtrat, me banjë e ujë brenda në dhomë, janë shërbime që i ofrohen të sëmurëve Para dhe Tetraplegjikë”.

⁵ Akt nr. 799 prot, datë 26.05.2016.

Përkundrazi, në nenin 25, pika 1 të VKM-së Nr. 303, datë 25.3.2009, e ndryshuar⁶: “Për miratimin e Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve”, parashikohet qartë se: “I paraburgosuri/ i dënuari qëndron në dhomën e pranimit jo më shumë se 10 ditë dhe më pas, vendoset në ambjentin e banimit. Në vendosjen e të paraburgosurve/ të dënuarve nëpër dhoma mbahen parasysh kritere që lidhen me gjendjen e tyre gjyqësore, faktin nëse janë ose jo përsëritës, llojin e veprës penale, masën e dënimit, moshën, gjendjen shëndetësore dhe nevojat mjekësore, arsimin, veçoritë intelektuale dhe psikike, kërkesat e veçanta për trajtimin e tyre, problemet konfliktuale, fakti nëse janë nën hetim për të njëjtën çështje penale me persona të tjerë të ndaluar me urdhër të prokurorit apo të gjykatës”.

Në rastin konkret, rezulton se Drejtoria e IEVP Krujë nuk ka marrë në konsideratë as moshën e të dënuarit⁷, as gjendjen shëndetësore dhe as nevojat e veçanta të ankuesit. Siç është përmendur më sipër, ankuesi gëzon statusin e plotë të invaliditetit, pasi është diagnostikuar me CA të Vezikës Urinare, ndërsa akti i ekspertimit mjeko-ligjor tregon se ankuesi vuan edhe me Diabet Mellitus II. Megjithatë, IEVP-ja e Krujës, ka kundërshtuar sistemimin e tij në dhomë të veçantë me shtrat, banjë e ujë brenda, pavarësisht gjendjes shëndetësore.

Në referencë të nenit 28, pika 1 dhe 3, të VKM-së së mësipërme lidhur me të drejtën për dalje në ajrim të të dënuarve, parashikohet se: “1. Të paraburgosurit/ të dënuarit dalin në ajrim në ambiente të hapura çdo ditë të javës, përfshirë ditët e shtuna, të diela dhe festat zyrtare dhe jo më pak se dy orë në ditë. Kufizimi i orarit të ajrimit bëhet vetëm për shkaqe të jashtëzakonshme dhe vetëm me urdhër të Drejtorit të institucionit. Ajrimi kryhet në vendin e caktuar sipas grafikut të miratuar. 3. Në raste të veçanta ose për të sëmurët, me rekomandim të mjekut të IEVP, lejohet dalja në ajrim shtesë, pasi mjeku të shpjegojë me shkrim arsyet e dhënies së kohës shtesë për ajrim dhe afatin e përcaktuar”.

Lidhur me pretendimin e ankuesit për orë më të zgjatura ajrimi, mbështetur në aktet e Ekspertimit Mjeko-Ligjor, për gjendjen shëndetësore të tij, nuk rezulton asnjë shkresë/parashtrim me shkrim nga ana e IEVP Krujë, ku mjeku të rekomandojë lejimin për dalje në ajrim shtesë, të të dënuarit I.S..

Përsa më sipër, është e dukshme se ekspertët mjeko-ligjorë kanë anashkaluar faktin se i dënuari është invalid, për më tepër me një diagnozë sic është “CA e Vezikës Urinare”, që kërkon kushte specifike trajtimi. Mosnjohja e kësaj diagnoze, ka krijuar kështu një pengesë reale që i pamundëson atij gëzimin e të drejtave, që janë parashikuar me ligj, edhe pse është i dënuar.

⁶ VKM nr.187 datë 17.03.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në vendimin nr.303 datë 25.03.2009, të Këshillit të Ministrave,

⁷ I dënuari I.S. është i datëlindjes 20.08.1955.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, mbështetur në dispozitat e ligjit 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenit 2, pika 1 e: *“Diskriminimi” është çdo dallim, përjashtim, kufizim apo preferencë, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi*”;

Nenit 7, pika 1 e po këtij ligji, *“Çdo veprim ose mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash, përbën diskriminim”*,

Si dhe në referencë të Ligjit nr. 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, neni 5 paragrafi 2: *“Të paraburgosurit dhe të dënuarit trajtohen pa njëanshmëri dhe pa diskriminim mbi bazë gjinie, race, ngjyre, përkatësie etnike, gjuhe, feje, bindjeje politike, fetare ose filozofike, orientimi seksual, identiteti gjinor gjendjeje ekonomike, arsimore ose shoqërore, përkatësie prindërore, moshe, gjendjeje familjare ose martesore, gjendjeje shëndetësore, aftësie të kufizuar, shtetësie ose përkatësie në një grup të caktuar ose për çdo shkak tjetër që përbën diskriminim”*,

Komisioneri vlerëson se mosveprimet e IEVP për njohjen e gjendjes shëndetësore të të dënuarit, sic janë parashikuar në vërtetimet e lëshuara nga KMCAP, janë bërë shkak për trajtim të padrejtë dhe diskriminues ndaj tij.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në ligjin nr. 10 221, datë 04.02.201 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, nenet 1, 3, nenin 4 pika 1, nenin 7 pika 1, nenin 21 pika 1, nenin 32 pika 1 gërma a) dhe c) dhe nenin 33,

Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Konstatimin e diskriminimit të ankuesit (dënuarit) I.S., nga ana e IEVP Zahari, Krujë, për shkak të gjendjes së tij shëndetësore.



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al

2. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, rekomandohet marrja e masave të menjëhershme nga ana e IEVP Zahari Krujë, për njohjen e gjendjes shëndetësore, siç është parashikuar nga KMCAP dhe trajtimin e tij mjekësor.
3. Referuar pikës 1 të këtij Vendimi, rekomandohet marrja e masave të menjëhershme nga ana e IEVP, Zahari Krujë për sigurimin e një dhome të veçantë me banjë e ujë brenda dhe orë më të zgjatura ajrimi.
4. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga marrja dijeni për këtë vendim, IEVP Zahari, Krujë, të njoftojnë Komisionerin, lidhur me masat e marra për zbatimin e tij.
5. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, brenda afateve të parashikuara me ligj.

KOMISIONERI

IRMA BARAKU

Shkak – gjendja shëndetësore
Fusha – Të mira dhe Shërbime
Lloji i vendimit - diskriminim



Adresa: Rruga Sami Frasheri, Nr.10, Kati II, Tiranë
(Tek godina e Fondit Shqiptar të Zhvillimit)
Tel: +355 4 2431078
Fax: +355 4 2431077
e-mail: info@kmd.al
web: www.kmd.al